

I. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 1 (një) vend pune për personel ndihmësakademik me kohë të plotë në pozicionin e Specialistit të Monitorimit pranë Departamentit të Sizmologjisë, në Institutin e Gjeoshkencave.

A. Kandidatët për personel ndihmës akademik në Departamentin e Sizmologjisë, duhet të plotësojnë kriteret si më poshtë:

1. Të zotërojnë diplomë të nivelit të dytë, preferohet “Master i Shkencave” në drejtimin “Shkencat e Tokës”;
2. Preferohen kandidatët me eksperiencë pune në përpunim të dhënash;
3. Të kenë njohuri të mira kompjuterike në përdorimin e sistemit operativ Linux dhe Software Seisan;
4. Të kenë njohuri të mira të gjuhës anglze, të dokumentuar me dëshmi përkatëse;
6. Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup;
7. Të jenë të disponueshëm dhe të punojnë në monitorim të vazhdueshëm në sistemin me 3 – turne (regjim observatori 24/7).

II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MASR);
5. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
6. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
9. Dëshminë e gjuhës së huaj të noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **06.04.2022** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.